REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 100/17
Datë/Datum. 24.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 100/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Ekrem Salihu - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Infinit Sh.p.k"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat zjarrfikësit dhe shëndetësinë kontratë njëvjeçare" me nr. prok. KA 652/16/109/121, iniciuar nga AK- /Komuna Kaçanik/ më datën 18.05.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Hedhet poshtë**, si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik "Infinit Sh.p.k"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat zjarrfikësit dhe shëndetësinë kontratë njëvjeçare" me nr. prok. KA 652/16/109/121 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Komuna Kaçanik /.

II. **Vërtetohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së / Komuna Kaçanik /, lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat zjarrfikësit dhe shëndetësinë kontratë njëvjeçare" me nr. prok. KA 652/16/109/121.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 25.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar

dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj;

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Infinit Sh.p.k"-Prishtinë,- hedhet poshtë si e pa lejuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:15.12.2016

Hapja e ofertave është bërë me dt:05.01.2017, ku kanë marr pjesë shtatë operator ekonomik.

Njoftimi i fundit dhënie kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:24.03.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Rilinda Sh. p. k"-Prizren.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik Infinit Sh. p. k"-Prishtinë, me dt: 29.03.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 30.03.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, NTG"Blendi"- Prishtinë

Operatori ekonomik ankues "Infinit Sh. p. k"-Prishtinë,, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 07 Prill 2017 me nr. 100/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material harxhues – administrativ për SHCK-ën, shkollat zjarrfikësit dhe shëndetësinë kontratë njëvjeçare" me nr. prok. KA 652/16/109/121 të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Komuna Kaçani" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-diskriminimi
- Neni 10 - Mjetet per promovimin e transparencës
- Neni 23 – Zyrtarët e Prokurimit
- Neni 59 paragrafi 4 - Ekzaminim, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 61 - Tenderët jo-normalisht të ulët, paragrafi 2- 2.1/2.2/2.3/2.2/4
- Neni 112 – Efekti pezullues i ankesave
- Neni 131 – Shkelja e ligjit nga Autoriteti Kontraktues

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 24.04.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 04.05.2017, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna Kaçanik, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material harxhues - administrativ për shck-ën, shkollat zjarrfikësit dhe shëndetësinë", me nr. të Prokurimit: KA-652-16- 109-121, në përgjithësi ka respektuar dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të **Refuzoj** ankesën si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, njoftimin për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 08.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 08.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtue,Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18. 05. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues,

përfaqësuesi i OE ankues, ekspertja e OSHP-së,vëzhgues nga OJQ "D Plus" u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Uka ka deklaruar: Ne kemi ofruar fakte me dudë doganor dhe me fatura për mallin që kemi ofruar me çmime për cilat i ka vlerësuar eksperti si çmime të ulëta.

Ndërsa OE Rilindja nuk ka ofruar prova dhe vetëm me përgjigje ne emali kanë thënë se po i ofrojnë ato çmime, dhe vet kthimi përgjigjes ka qenë me vonesë katër ditë. Pozicioni 131, në pozicionin 154 OE rilindja i njëjti toner është ofruar me çmim 0.10€ në pozicionin 154 ku sasia është 100 copë, dhe në pozicionin 131 ka ofruar çmim 20 € ku sasia është 10 copë. Vetëm me këtë pozicionin OE i rekomanduar del me çmim 800 më lirë se ne. Po ashtu në pozicionin 33 "folje për grafoskop" OE i rekomanduar ka ofrua r çmim 0.10€. I ofroj panelit si provë parashtresën në formë të shkruar me gjitha pretendimet tona dhe pikat ku nuk pajtohemi me konstatimet e ekspertit. Po ashtu AK ka kërkuar nga OE i rekomanduar që brenda ditë ti kthej përgjigje AK-së lidhur me çmimet dhe kjo nuk është bërë nga OE. I propozojmë panelit të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi të AK z. Koxha ka deklaruar: Lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta edhe herën e parë kemi kërkuar sqarime dhe kanë ofruar. Sqarimet e OE të rekomanduar nuk janë me vonesë. Është e vërtetë se OE i rekomanduar ka çmime me 0.10€, mirëpo edhe OE ankues po ashtu ka ofruar pozicione me çmim 0.05€ si në pozicionin 33.

Pozicionin 135 OE ankues e ka çmim 1€, në pozicionin 132 e ka çmim 1€, si dhe pozicione tjera me çmime të ulëta. Bazuar në nenin 61 të LPP ne kemi pa të arsyeshme që OE i rekomanduar mund ti përmbahet çmimeve te ofruara dhe të bëj furnizimin sipas rregullave.

Partneri i Infinit në këtë procedurë Grafoloni, ka ber vërejtje nga AK për mos zbatim të kushteve të kontratës. Kjo lëndë është stërzgjatur dhe duke i nis se kjo lëndë është shqyrtuar njëherë nga OSHP , i propozoj panelit të vërtetoj vendimin e AK si të bazuar dhe vazhdojmë me procedura të mëtutjeshme.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertes shqyrtuese të prokurimit znj. Saramati e cila deklaroj: I propozoj panelit shqyrtues të refuzoj ankesën e OE ankues si të pabazuar.

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj: qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 04.05.2017

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues

konform nenit 61 paragrafi 1 të LPP-së me dt:16.03.2017 ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në lidhje me disa pozicione ku është menduar se ky operator ekonomik ka ofruar çmime tej normalisht të ulëta. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë me dt: 20.03.2017 i është përgjigjur autoritetit kontraktues duke sqaruar pozicionet për të cilat ka ofertuar me çmime më të ulëta dhe duke konfirmuar se qëndrojnë prapa atyre çmimeve dhe duke u zotuar se mund ta përmbush kontratën në fjalë me këto çmime që ka ofruar. Autoriteti kontraktues konform nenit 61 paragrafi 3 të LPP-së i ka marr për bazë shpjegimet dhe e ka trajtuar këtë ofertë sikurse tenderët tjerë.

Paneli shqyrtues konstaton se edhe vetë operatori ekonomik ankues në disa pozicione ka ofruar çmime që duken jo normalisht të ulët, mirëpo që në total rezulton se ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se sa OE i rekomanduar për kontratë, prandaj operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky operator ekonomik ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Gjithashtu operatori ekonomik ankues është palë pa interes juridik material siç u cek më lartë edhe për faktin se nuk ka parashtruar pretendime ndaj OE "Stargraf" dhe "Promix" të cilët kanë ofertuar me çmim më të lirë se operatori ekonomik ankues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna Kaçanik"

1x1 OE "Infinit Sh.p.k"-Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.